



C.nr.583/12

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesional Alban Beqiri në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] të cilën e përfaqëson [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurit, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED] për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 5.543,13 €, pas seancës publike të mbajtur më 11.02.2015, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe të paditurit mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses, [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] i [REDACTED] ([REDACTED])

II.DETYROHET e paditura [REDACTED] që ta paguaj taksën gjyqësore për padi dhe aktgjykim në shumë prej 100.00€ të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja, [REDACTED] [REDACTED] ([REDACTED]), në këtë Gjykatë me dt.23.08.2012, ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj të paditurit si debitor për pagesën e borxhit në lartësi prej 5.543,13 €, në bazë të dokumentit autentik duke provuar me faturën nr.DFE-[REDACTED] të dt.20.06.2012.

Kjo Gjykatë me aktvendim E.nr. 1259/12, ka lejuar përmbarimin ndaj të paditurit si debitor, i padituri në aktvendim mbi lejimin e përmbarimit në afatin e paraparë ligjor me dt.03.10.2012, ka parashtruar kundërshtim me arsyetim se borxhit i ngarkuar në emër të tij është parashkruar sipas nenit 378 par.1 të LMD.

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë për përmbushjen e borxhit – pagesës së borxhit në

shumë prej 5,543.13€, në emër të shpenzimeve të energjisë elektrike të cilat i ka krijuar i padituri, dhe ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon padinë dhe kërkesë padinë si të bazuar.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

I padituri në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesë padinë e paditëses duke theksuar se borxhi i cili është objekt i këtij kontesti është parashkruar dhe kërkesë padia si e tillë është e pabazuar ka kërkuar nga ana e gjykatës që të njëjtën ta refuzon si të pabazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike bëri administrimin e provave: Lexohet Fatura e paditëses dt.20.06.2012 transaksioni i konsumatorit për të paditurin ,

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestuese se ka ekzistuar raporti i marrëdhënies juridiko-civile mes palëve kontraktuese për furnizim me energji elektrike mes palëve ndërgjyqëse sipas nenit 26 të LMD dhe nga këto raporte janë krijuar të drejta dhe detyrime konform nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara–faturat.

I padituri si në kundërshtim të paraqitur kundër propozimit për ekzekutim ashtu dhe në seancën shqyrtimit kryesor është thirrur në parashkrimin e kërkesë pasurore-juridike.

Sipas nenit 378 par.1 të LMD, kërkesa pasurore juridike për nevoja shtëpiake parashkruhen për një vjet, paditësi ka paraqitur propozim për ekzekutim që tani konsiderohet padi në gjykatë me dt.23.08.2012, siq shihet nga transaksioni i konsumatorit i padituri nuk ka bërë pagesë të energjisë elektrike nga viti 2002 deri më 09.12.2013, ku siç shihet kanë kaluar mbi një vite, meqenëse as paditësi nuk e ka bërë precizimin e kërkesë padisë e njëjta është parashkruar.

Nga transaksioni i konsumatorit DFE [REDAKTUAR] dt.11.02.2015 i padituri nuk ka bërë asnjëherë asnjë pagesë të energjisë elektrike deri më datën 09.12.2013, kurse paditësi padinë e ka paraqitur padinë në gjykatë me datën 23.08.2012, me të cilën ka kaluar mbi një vite dhe kërkesë padia e paditësit mbi këtë bazë është parashkruar, sipas 378.1 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 50 € dhe aktgjykim prej, 50 €, gjithësej në lartësi prej 100 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr. 583/12 më dt.11.02.2015



Gjyqtari:
Enes Mehmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

